



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 103

Prishtinë, më 17.3.2014, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 1

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Behar Selimi, Mufera Shinik, Armend Zemaj, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi dhe Sreten Ivanoviq.

Munguan: Arben Gashi, Haki Demolli, Arsim Bajrami, Ardian Gjini dhe Albulena Haxhiu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Declan O'Mahony, Jasmine Sultan dhe Artan Canhasi – EULEX, Behlul Zeka – EUSR, Lumnije Murati – ZPRK, Sylë Ahmeti – Kosova Sot, Valmira Saraçi – KTV, Sahadete Zogaj – Kosova Press, Ardian Bajraktari – MD, Kaltrina Ahmeti dhe Qendresa Mrasori – KDI.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Behar Selimi, nënkryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 3 dhe 10.2. 2014;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësit e Deputetit;
5. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të grupit punues në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-190 për Produkte Medicinale dhe Pajisje Medicinale;
8. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-250 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror;
9. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore;
10. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-253 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë;
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi konstatoi se rendi ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 3 dhe 10.2. 2014

***Kryesuesi** konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 3 dhe 10.2. 2014, pa vërejtje.*

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës.

Kryesuesi tha se tashmë jeni të njoftuar me historikun e këtij Projektligji, i cili i është kthyer Qeverisë e cila i ka bërë disa ndryshime. Ka mendime të ndryshme se ky Projektligj është kundër kushtetues megjithatë ne, si Komision, i kemi funksionet politike dhe në aspektin politik mendoj se është me interes për vendin që ta aprovojmë në parim, sepse ky Projektligj në të ardhmen na mundëson kthimin e dokumentacionit kadastral në Kosovë. Kjo do të jetë e mundur vetëm në mbështetje të faktorit ndërkombëtar, andaj mendoj që është mirë ta miratojmë në parim dhe sa i përket vlerësimit të kushtetutshmërisë është Gjykata Kushtetuese.

Armend Zemaj tha se ky Projektligj është diskutuar disa herë dhe kemi vlerësuar se është i nevojshëm ky Projektligj dhe roli i Agjencisë Kosovare të Pronave mbetet permanent dhe duhet të kemi qasje serioze ndaj saj. Por kundërshtimi jonë vazhdon për faktin se marrëveshjet e arritura në Bruksel është dashur të jenë transparente. Përkufizimet e përdorura në këtë Projektligj tregon se qasje e atyre marrëveshjeve është këtu. Kurse sa i përket aspektit kushtetues jam i rezervuar, sepse pa pasur gjithë dokumentacionin bazë nuk mund të japim një mendim

profesional. Unë do të abstenoj nga miratimi në parim i këtij Projektligji, kurse opinionet tona do t'i japim në seancë.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni me shumicë të votave nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektligji për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësit e Deputetit

Kryesuesi ftoi z. Armend Zemaj ta arsyetojë procedimin e projektligjit.

Armend Zemaj tha se Projektligji tashmë është vendosur në takimet e kaluara të Komisionit që të procedohet tutje, por ajo pse sot e kemi futur në rend dite është njoftimi me koston financiare të cilën e ka bërë drejtoria për buxhet dhe pagesa e Kuvendit. Ai për hir të informimit të drejtë të opinionit tha se përfitues, sipas këtij ligji, do të jenë ish- deputetët që e mbushin moshën e pleqërisë dhe jo deputetët aktual siç po thuhet nganjëherë në mjetet e informimit. Kostoja e këtij Projektligji është minimale edhe pse janë përfshirë të gjitha legjislaturat nga viti 90, 92, 98 dhe legjislaturat pas vitit 1999, pra e gjithë kostoja është 495 mijë euro. Prandaj shpresojmë që kjo nuk do të jetë barrë e rëndë për buxhetin e Republikës së Kosovës, sepse numri i atyre që përfitojnë nga ky ligj nuk është i madh.

Gëzim Kelmendi tha se edhe në Nënkomision edhe në Komision unë kam qenë kundër këtij ligji dhe dilema kryesore është rreth pensionit suplementar. Sipas tij pensioni i deputetit duhet të jetë i njëjtë me të gjithë pensionet e tjera të shoqërisë. Po ashtu duke u lidhur me diskutimet e parafolësit rreth privilegjeve të tjera tha se privilegj është vetë fakti që deputeti gjatë mandatit të tij ka pagë diku shtatë herë më e madhe se paga mesatare në vend, kur kemi një standard kaq të ulët ekonomik, numër të lartë të papunësisë dhe tani me këtë ligj po dëshirojmë që vetes t'ia sigurojmë edhe pensionin, kjo aspak nuk është e moralshme. Ai tha se edhe në vizitat që kemi pasur në vendet e tjera kemi pasur se përveç Shqipërisë dhe Maqedonisë, shtetet e tjera nuk kanë ligj që siguron pensione suplementare dhe tani ne dëshirojmë që të mbetemi në nivel me këto vende kur kemi praktika më të mira të vendeve të zhvilluara. Kërkoj edhe nga deputetët e tjerë që duke pasur parasysh të gjitha këto arsye nuk është koha dhe nuk është aspak etike që t'i sigurojmë vetes pensione suplementare. Prandaj unë për këto arsye nuk do ta përkrahë këtë ligj.

Armend Zemaj ai kërkoi nga të gjithë që para se të falsin për këtë projektligj ta analizojnë legjislacionin relevant, sepse unë edhe disa nga anëtarët që jemi këtu ky Projektligj nuk bëhet për

ne pasi kemi një moshë shumë të re, por ligji po bëhet siç thashë për ish- deputetët e që e mbushin moshën e pleqërisë. Kurse duke u ndërlidhur me parafolësin tha se paga mesatare e deputetit nuk është shtatë herë më e lartë se paga mesatare në vend e që është 350 ero. Po ashtu tha se nuk është pension suplementar, ashtu siç i përmendi z. Kelmendi, sepse vendet si Shqipëria dhe Maqedonia kanë pension të deputetit nëse nuk punon deputeti, kurse ne e kemi futur pas moshës së pleqërisë. Edhe një herë po përmendi që arsyeja e futjes sot në rend dite ishte për qëllim të informimit të drejtë të opinionit lidhur me koston financiare pasi Projektligji e ka marrë pëlqimin e Komisionit që të procedohet tutje.

Halit Krasniqi tha se edhe pse nuk kam qenë pjesë e grupit që ka punuar me shumë përgjegjësi për këtë Projektligj vlerësoi se ka bërë një punë të mirë sidomos me ndryshimet e fundit. Në rangun e funksioneve të larta funksioni i deputetit është më i diskriminuari. Theksoi se deputeti te ne duhet të jetë shofer, këshilltar dhe shumë çështje të tjera logjistike për dallim nga vendet e tjera që janë shumë më të avancuara në këtë aspekt. Ishte i mendimit që Projektligji duhet të procedohet tutje, kurse për shumë çështje do të diskutoj edhe në seancë plenare.

Deputetët Armend Zemaj dhe Gëzim Kelmendi kishin mendime të ndryshme rreth procedimit të projektligjit dhe pas diskutimeve, kryesuesi, konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Komisioni për Legjislacion, ka hartuar Projektligjin për Deputetët dhe, në pajtim me rregulloren e Kuvendit, Kryesisë së Kuvendit, ia dërgon Projektligjin për procedim të mëtejshëm.

5. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të grupit punues në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Kryesuesi paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen për Projektligjin dhe amendamentet, nëse kanë vërejtje. Në bazë të raportit shihet që amendamentet e deputetit Goran Marinković janë të karakterit gjuhësor që është obligim i zyrës për Standardizim që t'i rregullojë e që nuk janë përkrahur as nga grupi punues.

Meqë nuk kishe diskutime tjera, kryesuesi konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

P ë r f u n d i m

I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit për Legjislacion.

II. Raporti me amendamente i Komisionit për Legjislacion procedohet për shqyrtim të mëtejme në Komisionet kryesore.

III. Amendamentet e miratuara dhe amendamentet që nuk e kanë marrë përkrahjen e Komisionit janë paraqitur si aneks i këtij procesverballi.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Kryesuesi paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët që nëse kanë vërejtje në Projektligj dhe amendamente t'i paraqesin.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-190 për Produkte Medicinale dhe Pajisje Medicinale

Kryesuesi, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-190 për Produkte Medicinale dhe Pajisje Medicinale dhe kërkoi nga anëtarët që nëse kanë vërejtje në Projektligj dhe amendamente t'i paraqesin.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 04/L-190 për Produkte Medicinale dhe Pajisje Medicinale, dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

8. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-250 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror

Kryesuesi, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-250 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror dhe kërkoi nga anëtarët që nëse kanë vërejtje në Projektligj dhe amendamente t'i paraqesin.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 04/L-250 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

9. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore

Kryesuesi, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore dhe kërkoi nga anëtarët që nëse kanë vërejtje në Projektligj dhe amendamente t'i paraqesin.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

3. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

10. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-253 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë

Kryesuesi paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-253 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë dhe kërkoi nga anëtarët që nëse kanë vërejtje në Projektligj dhe amendamente t'i paraqesin.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 04/L-253 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

11. Të ndryshme

Në këtë pikë nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Nënkryetari i Komisionit
Behar Selimi

Aneks – Amendamentet në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Amendamenti 1

Neni 1 hiqet dhe radhitja e neneve vazhdon sipas numrave me radhë

Amendamenti 2

Propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Amendament për titullin dhe preambulën e ligjit,

Në titullin e projektligjit propozojmë që në vend të lidhëzës **I** ndryshimeve të zëvendësohet me **O**, si dhe fjala procedura të ndryshojë me procedurat.

Propozohet ndryshimi i radhitjes së fjalëve në titull dhe preambulën e Ligjit, kështu që fjalët **“dopunama i izmenama “** do të zëvendësohen me **“izmenama i dopunama“**

Në vend të fjalës **“procedure”** duhet të jetë **“procedurama”**.

Amendamenti 3

Neni 3 dhe 4 hiqen dhe radhitja e neneve vazhdon sipas numrave me radhë

Amendamenti 4

Propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Neni 1.1 fjala **“procedure”** duhet të jetë **“procedurama”**.

Amendamenti 5

Neni 6 paragrafi 1.6 në rreshtin e dytë hiqet lidhësja **“apo”** dhe zëvendësohet me **“presje”** pas fjalës publike shtohen fjalët **“dhe shërbimeve publike”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 6

Propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Neni **9** i ligjit bazik, parag. 12., fjala **„penjanje”** zëvendësohet me fjalën **“hapje”**.

Amendamenti 7

Neni 10 paragrafi 1 Hiqen fjalët **“ Personat zyrtar”** dhe zëvendësohen me fjalët **“Zyrtarët e lartë publik”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 8

Neni 11 paragrafi 14 dhe 15 hiqen

Amendamenti 9

Neni 13 paragrafi 1 në rreshtin e parë hiqet fjala “ **ushtron**” dhe zëvendësohet me fjalën “**paraqet**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 3 në rreshtin e parë hiqet fjala “ **procedimin**” dhe zëvendësohet me fjalën “**procedurën**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 10

Propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 25.6.2 Fjala **kontest** zëvendësohet me **konflikt**, si dhe fjala **bira se** zëvendësohet me **izabere**.

Neni 25.6.3 Fjala **ispunjenja** zëvendësohet me **popunjenja**